



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

REAGIM PUBLIK!

23 qershor 2023
Prishtinë

Gjatë ditës së djeshme në njërën nga mediat elektronike, përkatësisht tek **Nacionale.com**, është publikuar lajmi lidhur me mungesën në vendin e tij të punës të Dr. Vigan Mahmutaj- Specialist i Kardiologjisë njëkohësisht anëtar i Odës Mjekëve të Kosovës, duke aluduar se ai nuk ka qenë prezent në vendin e tij të punës në Klinikën e Kardiologjisë, përkatësisht në Ambulancën Specialistike të Kardiologjisë në QKUK.

Ky lajm është publikuar sipas deklaratës së dhënë nga një pacient që ka qenë nën trajtim të vazhdueshëm mjekësor nga Dr. Vigan Mahmutaj, pacient i cili gjatë ditës së djeshme ka pasur të caktuar kontrollën rutinë sipas protokoleve mjekësore.

Pas publikimit të një lajmi të tillë, gjithsesi shqetësues, se në bazë të hetimeve të bëra nga OMK dhe dëshmive që OMK posedon Dr. Vigan Mahmutaj nga data 2 qershor 2023 e deri me datë 30 qershor 2023, është në pushim vjetor të lejuar nga drejtori i Klinikës së Kardiologjisë, dhe gjatë periudhës së mungesës së tij në punë, detyrat dhe përgjegjësitë e punës i kanë kaluar kolegëve të tij nga Klinika e Kardiologjisë. Andaj, referuar videos dhe lajmit të publikuar nga **Nacionale.com**, pacienti nuk e mohon se shërbimet mjekësore i janë ofruar gjatë ditës së djeshme datë 22 qershor 2023, por pacienti ka refuzuar të trajtohet nga kolegët e Dr. Vigan Mahmutaj të cilët kanë qenë duke ofruar shërbime mjekësore në Ambulancën Specialistike të Kardiologjisë në QKUK, në ditët kur pacienti ka ardh për kontrollë rutinë përfshirë këtu edhe ditën e djeshme.

Pra, me këto fakte mund të konstatojmë se janë respektuar në plotëni Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, të cilin mund ta konsultoni në:

<https://omk-rks.org/wp-content/uploads/2020/01/KO-32-2019-Kodi-Etik-i-OMK-s-%C3%AB.pdf>

Si rrjedhojë e kësaj ngjarje, iu bëjmë thirrje të gjitha mediave që të jenë më të kujdesshme gjatë krijimit të lajmeve duke ruajtur konfidencialitetin dhe të respektojnë etikën e gazetarisë profesionale duke mos bien pre e keqinformimit apo informacionit të njëanshëm pa verifikuar dhe siguruar deklaratat e të gjitha palëve të përfshira.

Prandaj do ishte etike dhe profesionale nga mediumi **Nacionale.com**, që menjëherë ta demantoj publikisht dhe të largoj video-lajmin e publikuar me datë 22 qershor 2023 për Dr. Vigan Mahmutaj, në të cilin doktori në fjalë linçohet, denigrohet dhe dëmtohet imazhi i profesionit më fisnik, atij të MJEKUT!

Ndërsa, iu bëjmë thirrje të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët janë marrës të shërbimeve mjekësore që në rastet kur konsiderojnë se nuk po trajtohen sipas protokoleve të caktuara mjekësore, ankesat e tyre t'i adresojnë në institucionet gjegjëse.

Ne jemi aty ku Ju nuk dëshironi të jeni!

Me solidaritet,

Kryetar i OMK-së
Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.Sci

